REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"

Konsultim publik : Lagjia nr.2.

Data : *23.09.2026* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Salla e Këshillit Bashkiak.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesmarrësve 23, nga të cilat 5 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2027-2029 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

I. Paraqitja e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit

Takimi u hap nga **z. Oltion Luli**, Kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër, i cili ftoi banorët të paraqisnin problematikat dhe propozimet e tyre dhe të përcaktonin prioritetet që, sipas nevojave të komunitetit, duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit të buxhetit të vitit 2027 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.

Pjesëmarrësit u ftuan të fokusoheshin në nevojat që lidhen me funksionet dhe shërbimet e Bashkisë Shkodër, përfshirë infrastrukturën rrugore, ujësjellës-kanalizimet, ndriçimin publik, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve, hapësirat publike, transportin, arsimin dhe nevoja të tjera të komunitetit.

II. Diskutimet, kërkesat dhe propozimet

Z. Rubin Borshi, administrator i Rajonit nr. 2: Falënderoi pjesëmarrësit dhe theksoi se nevojat e zonës janë të shumta. U shpreh se administrata do të bashkëpunojë me komunitetin për të evidentuar ndërhyrjet që mund të financohen dhe për t'i renditur ato sipas prioritetit.

Z. Fatmir Dekovi, banor i lagjes Partizani: Kërkoi që një rrugicë rreth 100 m, pranë zonës së Merkatës së Rusit dhe lëvizjes së Postribës, të përfshihet në buxhet dhe të trajtohet si prioritet për investim.

Z. Ermir Kraja, banor i rrugës Gërçari: Ngriti problematikën e rrugës Gërçari, ku banesat përdorin gropa septike. Sqaroi se është vendosur rrjeti i ujësjellësit, por rruga ka nevojë për asfaltim. Kërkoi gjithashtu afrimin e pikave të grumbullimit të mbetjeve, të cilat aktualisht janë larg banesave.

Z. Rubini Borshi, administrator i Rajonit nr. 2: U shpreh i gatshëm të bashkëpunojë me komunitetin për të përcaktuar vendet më të përshtatshme për vendosjen e kazanëve shtesë të mbetjeve.

Znj. Fatmira Hoxhaj, mësuese dhe banore e zonës: Mbështeti problematikën e ngritur për rrugën Gërçari dhe nevojën për ndërhyrje në këtë segment.

Z. Ridvan Hivziku: Mbështeti të njëjtën kërkesë për rrugën Gërçari dhe nevojën për përmirësimin e infrastrukturës së saj.

Z. Reshit Kurtulaj, banor i lagjes Guerrile: Kërkoi trajtimin e një rruge në lagje, rreth 150 m, që ka nevojë për mirëmbajtje. Ngriti gjithashtu kërkesën e banorëve për ndryshimin e emërtimit të rrugës, për të cilën ishte komunikuar më parë pa marrë ende zgjidhje.

Z. Oltion Luli, Kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër: Sqaroi se për emërtimet dhe ndryshimet e emrave të rrugëve pritet miratimi i rregullores përkatëse dhe se, pas miratimit të saj, banorët mund të paraqesin kërkesë të shoqëruar me dakordësinë e komunitetit.

Z. Denis Zmijani, banor i lagjes Partizani: Kërkoi ndërhyrje të plotë në një rrugicë rreth 70-80 m, e cila, sipas tij, nuk ka kanalizime dhe rrjet ujësjellësi. Theksoi se gjatë reshjeve të shiut hyrja dhe dalja në rrugicë bëhet shumë e vështirë.

Znj. Monika Mustafa, banore përballë spitaleve: Paraqiti disa kërkesa për zonën: nevojën për investim në ashensorin e pallatit; rishikimin e problematikës së qarkullimit dhe sinjalistikës në rrugicat përballë spitalit, ku banorët përballen me gjoba; shfrytëzimin e një hapësire publike të liruar për krijimin e një këndi lojërash për fëmijë; si dhe përmirësimin e shërbimit të transportit publik, për shkak të vonesave të shpeshta.

III. Evidentimi i prioriteteve dhe dokumentacioni

1. Përfshirja në planifikimin buxhetor e rrugicave prioritare në lagjen Partizani dhe mirëmbajtja e rrugës së evidentuar në lagjen Guerrile.
2. Asfaltimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së rrugës Gërçari, përfshirë problematikat e kanalizimeve.
3. Shtimi dhe afrimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve sipas dakordësisë me komunitetin.
4. Ndërhyrja në rrugicën pa kanalizime dhe ujësjellës të evidentuar nga banorët e lagjes Partizani.
5. Trajtimi i kërkesës për ndryshimin e emërtimit të rrugës, pas miratimit të rregullores përkatëse.
6. Krijimi i një këndi lojërash në hapësirën publike të liruar përballë zonës së spitaleve.
7. Përmirësimi i transportit publik dhe rishikimi i sinjalistikës e aksesit në zonën përballë spitaleve.

Kërkesat, vërejtjet dhe propozimet e mësipërme administrohen si pjesë e dokumentacionit të këshillimit publik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe projektbuxhetin vjetor 2027. Ato pasqyrojnë ndërhyrjet dhe prioritetet e paraqitura gjatë takimit dhe nuk përbëjnë vendimmarrje të pjesëmarrësve.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Zbardhi proces verbalin:

Bekim Mema

Irma Sulishti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

KONSULTIM PUBLIK: ***" PËR DRAFT PROJEKT PLANIN BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"***

Lagjia nr.2 ***Datë: 23.09.2026***

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Fatmir Dekovi	Partizani	0695361799		
2.	Amar Nurtja	B.SHKODER	0697808081		
3.	Anisa Gjeleshi	B. Shkodër	0697707706		
4.	Xhoelda Shelpeja	Org. Sos Fshatit Fëmijve	0693628434	xhoelda.shelpeja@sosk3.org.al	
5.	Afërdita Fërhati	B. Shkodër	0694493380	afërditakolija 1996 @gm.c	
6.	Dëfrim Ferraj	vojo hoshi	0673580858		
7.	Altin Shabani	B. Shkodër	0672626966		
8.	Kristo Shely	DPMOP	0656411334		
9.	Joris Jesha	Prefektura			
10	Astrit Hoxha	Partizani	068 229 3899		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
11	Vildjana Hoxha	Partizani	0674801359		
12	ARSEN NUGI	PARTIZANI	0672729874		
13	Fatmira Gloxhaj	L. Nr 2	0695425160	fatmirahoxhaj61@gmail.com	
14	Bajrush Dashi	L Nr 2	0674542423		
15	Ermir Kraja	LP-	0672261416		
16	Rexhvan Luzhaku	L Partizani	0674045199		
17	Fatbardh Kus	HSHPP	0676305001		
18	Elsid Sadiku	NSHPP	0693810646	elsid.sadiku@bashkiashkoder.gov.al	
19	Deniz Zenijonaj	L.Nr 2	0692061777	d.zenijona@gmail.com	
20	Feim Qoku	L Nr.2	0696648184	Qoku	
21	Hajri Kabaja	L Nr 2	0696988847		
22	Reshit Tafaj	Qender	0685211138		
23	Monika Mustafaj	Lagj nr 2	0683343394	pojamonik@gmail.com	
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					